



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29 Qershor 2021

Nr. 420

**VENDIM**

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj “Albpetrol” sh.a
- Kërkues:** z. Andi Derhemi
- Ndaj:** “Albpetrol” sh.a
- Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, pika 2, dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

**VËREN:**

I. Vlerësimi paraprak



Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar një kallëzim me nr. 5504 prot., datë 27.5.2021, nga një denoncues, me objekt “Ndërprerja e marrëdhënies së punës”, në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncuesit pretendohet se: “Është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, brenda periudhës së fushatës zgjedhore, përkatësisht ka marrë njoftimin në datë 29.03.2021, me shkresën nr. 2143 prot., të lëshuar nga administratori i Albpetrol sh.a, z. Flamur Mato. Ky njoftim është në shkelje të nenit 3, pika 1.3, shkronja “d” të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.”.

Bashkangjitur denoncimit të kërkuesit është paraqitur dhe kopje e njoftimit nr. 2143 prot., datë 29.03.2021, “Mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”.

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk i’a njeh shprehimisht Rregullatorit apo Kas-it.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga denoncuesi përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

## II. Rrethanat e faktit

Referuar denoncimit të mësipërm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 5635 prot., datë 03.06.2021, i ka kërkuar informacion administratorit të Albpetrol sh.a, z. Flamur Mato, në lidhje me njoftimin e sipërcituar për sa i përket procedurës së ndjekur në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës.



Me shkresën nr. 3632/1 prot., datë 08.06.2021, administruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me nr. 5635/1 prot., datë 11.06.2021, z. Flamur Mato, Administratori i Albpetrol sh.a, ka sqaruar se: “Procesi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga pozicioni i drejtorit të prodhimit për të vazhduar kontributin pranë kësaj shoqërie në Drejtorinë e Furnizimit dhe Shërbimeve të Albpetrol sh.a u krye për shkak të emergjencave në proceset e punës që Drejtoria e Prodhimit ka në funksion si dhe rëndësinë e lartë që ka kjo drejtori për shoqërinë Albpetrol sh.a.

Z. Derhemi është komanduar në pozicionin e punës si drejtor i Drejtorisë së Prodhimit të Albpetrol sh.a, në datën 09.05.2019 me vendimin e nr. 210/1, me nr. 4353/1 prot. Struktura e Albpetrol sh.a e cila ka qenë e miratuar dhe funksionale në këtë kohë kishte si detyrim që drejtori i Drejtorisë së Prodhimit të kishte arsimin e lartë duke mos e specifikuar llojin e arsimit. Pra kryerja e funksioneve të drejtorit të Prodhimit nga z. Derhemi ka qenë jo përfundimtare por e përkohshme.

Në datë 28.09.2020 është emëruar në cilësinë e administratorit të Albpetrol sh.a, z. Baftjar Zeqaj, i cili në bazë të tagrave që i delegon ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në datë 11.01.2021, me urdhrin nr. 15, struktura e Albpetrol sh.a, pësoi disa ndryshime përfshirë dhe pozicionin e punës së drejtorit të Drejtorisë së Prodhimit, i cili duhet të kishte përfunduar arsimin e lartë si inxhinier në fushën e nxjerrjes dhe prodhimit të naftës.

Kjo kërkesë është lidhur ngushtë dhe me situatën e re e krijuar në shoqërinë Albpetrol sh.a, për arsye se me fillimin e situatës së pandemisë së Covid-19, por edhe si pasojë e mosrealizimit të ankandit të shitjes së naftës brut. Me fillimin normal të punës ishte e nevojshme që Drejtoria e Prodhimit të vihej në efikasitet të plotë. Duke marrë për bazë arsimimin e z. Derhemi kishte mospërputhje midis detyrave që duhej të kryente drejtori i Prodhimit dhe arsimimit të tij si ekonomist.

Në këto kushte kur pozicioni i punës sipas strukturës organizative duhej punonjësi me arsim të lartë në fushën e inxhinierisë së naftës dhe prodhimit si dhe emergjencat për shkak të natyrës së proceseve të punës së drejtorisë së prodhimit, kryerja e ankandit në muajin shkurt dhe fillimi i planit të lëvrimin të naftës brut, gjatë kësaj periudhe, kërkoi ndërhyrje të menjëhershme për zëvendësimin e drejtorit të Drejtorisë së Prodhimit.



Bashkëlidhur kësaj shkresë janë paraqitur materialet mbi procedurën e ndjekur dhe provat shkresore si:

1. Urdhri për strukturën organizative për Albpetrol sh.a, nr. 04, datë 20.01.2020;
2. Urdhri për strukturën organizative me specifikimet për secilin pozicion pune, nr. 15, datë 11.01.2021;
3. Shkresa nr. 1903 prot., datë 17.03.2021, njoftim për takim;
4. Shkresa nr. 2045 prot., datë 24.03.2021, procesverbal takimi;
5. Shkresa nr. 2143 prot., datë 29.03.2021, njoftim për ndërprerjen;
6. Shkresa nr. 2189 prot., datë 30.03.2021, njoftim për pezullim;

### III. Analiza ligjore

Neni 3, pika 1.3, shkronja “d” i vendimit nr. 9/2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator ka përcaktuar se “veprimtari të ndaluara”, janë dhe ato veprimtari që përfshijnë:

*“**gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organiken e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”.***

Për sa më sipër, veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer “**gjatë fushatës zgjedhore**” dhe në kundërshtim me **rastet e përligjura** të parashikuara në neni 3, pika 1.3, shkronja “d” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Referuar informacionit të përcjellë nga administratori i “Albpetrol sh.a”, konstatohet se, njoftimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës i datës 29.03.2021, është bërë si rrjedhojë e një sërë



procedurash në vijimësi të njëra tjetrës, që kanë për bazë ndryshimin organizativ të strukturës së Albpetrol sh.a, të miratuar me urdhrin nr. 15, datë 11.01.2021, përpara fushatës zgjedhore.

Referuar dokumentacionit të disponuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ janë të pamjaftueshme për të verifikuar dhe shqyrtuar rrethanat dhe faktet në bazë të të cilave është bërë njoftimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Referuar objektit të kallëzimit për “Ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga ana e tij, pikërisht për shkak të mungesës së kompetencës së tij lëndore.

Referuar ligjit nr. 9125, datë 29.7.2003 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar, organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, është gjykata kompetente.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

### **V E N D O S:**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj “Albpetrol” sh.a.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

